



SHOQËRIA CIVILE THOTË SE VETËVENDOSJA E KA BARRËN KRYESORE PËR KRIZËN AKTUALE

FAQE 4-5



Kanë kaluar më shumë se tre muaj pas zgjedhjeve dhe ende nuk kemi Kuvend të konstituuar dhe institucione funksionale. Sot (e shtunë) deputetët e Kuvendit të Kosovës do të mbledhen sërish për herën e 24 për të bërë një përpjekje të re

për ta konstituuar përbërjen e nëntë parlamentare të dalë nga zgjedhjet e shkurtit. Dështimet e njëpasnjëshme po ndodhin pavarësisht prej thirrjeve brenda dhe jashtë vendit për të lëvizur përpara për krijimin e institucioneve. Eugen Cakolli

nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje e ka barrën kryesore në krizën aktuale. Ai ka thënë se nëse askush nuk ndryshon qasje, edhe zgjedhjet e reja do ta prodhojnë të njëjtën krizë

KOMUNAT PO PËRBALLEN ME RRIJTJE TË LARTË TË SHPENZIMEVE NGA OBLIGIMET GJYQËSORE DHE PËRMBARIMORE F. 3



MINISTRIA E SHËNDETËSISË THOTË SE PO BËN PËRKUSHTIM TË VAZHUESHËM NË LUFTËN KUNDËR DUHANIT F. 7



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË

SPORT



SONTE FINALJA E MADHE E LIGËS SË KAMPIONËVE F. 10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Macroni: Franca mund ta ashpërsojë qëndrimin ndaj Izraelit, nëse vazhdon bllokimi i ndihmave në Gazë

PARIS, 30 MAJ - Franca mund ta ashpërsojë qëndrimin e saj ndaj Izraelit, nëse ai vazhdon t'i bllokojë ndihmat humanitare për Rripin e Gazës, tha të premten presidenti i Francës, Emmanuel Macron. Ai e përsëriti se Parisi është i përkushtuar ndaj zgjidhjes me dy shtete për ta zgjidhur konfliktin izraelit-palestinez. "Bllokada humanitare po krijon situatë të papërballueshme në terren", tha Macroni në një konferencë të përbashkët për shtyp me kryeministrin e Singaporit, Lawrence Wong, në Singapor. "Dhe, kështu, nëse nuk ka përgjigje të përshtatshme për situatën humanitare në orët dhe ditët në vijim, atëherë padyshim që do të duhet ta ashpërsojmë

qëndrimin tonë të përbashkët", shtoi Macron, duke theksuar se Franca mund ta shqyrtojë vendosjen e sanksioneve ndaj kolonëve izraelitë. "Por, unë ende shpresoj se qeveria izraelite do ta ndryshojë qëndrimin dhe përfundimisht do ta kemi një përgjigje humanitare", shtoi ai. Si rrjedhojë e trysisë së shtuar ndërkombëtare, Izraeli i dha fund pjesërisht javën e kaluar një bllokade 11-javore të ndihmave për Gazën, duke lejuar një sasi të kufizuar ndihmesh të hyjnë përmes një sistemi që është kritikuar bujshëm. Macroni tha se Parisi është i përkushtuar të punojë për një zgjidhje politike dhe përsëriti mbështetjen e tij për një zgjidhje

me dy shtete të konfliktit izraelit-palestinez. Qenia e një shteti palestinez "nuk është thjesht detyrim moral, por edhe domosdoshmëri politike", u tha Macroni gazetarëve në Singapor. Sipas diplomatëve dhe ekspertëve, Macroni po anon drejt njohjes së një shteti palestinez - një hap që mund ta zemërojë Izraelin dhe t'i thellojë përçarjet në Perëndim. Zyrtarët francezë po shqyrtojnë këtë hap në prag të një konference të Kombeve të Bashkuara, që Franca dhe Arabia Saudite do ta bashkorganizojnë nga 17 deri më 20 qershor, për t'i përcaktuar parametrat për rrugën drejt një shteti palestinez, duke garantuar njëkohësisht sigurinë



e Izraelit. Lufta në Gazë filloi kur militantë të udhëhequr nga Hamasi sulmuan Izraelin jugor, duke vrarë 1 200 njerëz dhe duke marrë rreth 250 pengje. Izraeli thotë se 58 pengje mbeten në

Gazë, megjithëse besohet se rreth 35 prej tyre janë të vdekur. Prej atëherë, lufta e Izraelit i ka vrarë më shumë se 53 000 njerëz në Gazë, shumë prej tyre gra dhe fëmijë, sipas zyrtarëve shëndetësorë palestinezë.

ShBA-ja në OKB: Rusia duhet ta pranojë marrëveshjen për përfundimin e luftës në Ukrainë

NJU-JORK, 30 MAJ - Përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kombet e Bashkuara, John Kelley, tha para Këshillit të Sigurimit të OKB-së të enjten vonë, se marrëveshja e tanishme që është ofruar për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë, është rezultati më i mirë i mundshëm për Rusinë dhe se presidenti Vladimir Putin duhet ta pranojë atë. "Zgjatja e luftës nuk është në interesin e askujt", tha John Kelley, përfaqësuesi i përkohshëm i ShBA-së në OKB, duke paralajmëruar se Shtetet e Bashkuara mund ta shqyrtojnë "tërheqjen" nga përpjekjet për bisedime, nëse Rusia "merr vendimin e gabuar për ta vazhduar këtë luftë katastrofike". Kelley shtoi se sanksionet shtesë kundër Rusisë janë ende në tavolinë. Kremlini tha të enjten se po pret përgjigjen e Kievit për propozimin e tij për bisedime të reja në Stamboll më 2 qershor. "Me aq sa di unë, ende nuk ka përgjigje... Duhet të presim një përgjigje nga pala ukrainase", tha



zëdhënësi i Kremilit, Dmitry Peskov. Këshilltari i lartë i presidentit ukrainas Volodymyr Zelensky tha se Ukraina është e gatshme të marrë pjesë, por dëshiron t'i shohë paraprakisht propozimet e Rusisë për përfundimin e luftës. "Ukraina është e gatshme të marrë pjesë në takimin e radhës, por duam të kemi një diskutim konstruktiv", tha Andriy Yermak. "Kjo do të thotë se është e rëndësishme ta marrim draftin e Rusisë", shtoi ai. Peskov e quajti kërkesën e tij

"jokonstruktive". Ukraina tha se i ka dorëzuar tashmë Rusisë vizionin e saj për një marrëveshje paqeje. Zelensky e akuzoi Rusinë për "një tjetër mashtrim" duke mos dorëzuar propozimin e saj për paqe para takimit të propozuar në Stamboll. "Edhe i ashtuquajtur 'memorandum' që premtuan dhe që gjoja është përgatitur prej më shumë se një jave, nuk është parë ende nga askush", tha Zelensky në adresimin e tij të përnatshëm me video. "Ukraina nuk e ka marrë

atë. As partnerët tanë nuk e kanë marrë. As Turqia, që e priti takimin e parë, nuk ka marrë agjendën e re", tha ai. "Pavarësisht premtimeve të kundërta, para së gjithash ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ndaj presidentit Trump: një tjetër mashtrim rus". Rusia tha se do të përdorë takimin e 2 qershorit për të paraqitur një "memorandum" që përshkruan kushtet e saj për një marrëveshje për paqe. "Delegacioni ynë, i udhëhequr nga Vladimir Medinsky, është gati t'i paraqesë një memorandum delegacionit ukrainas dhe të ofrojë shpjegimet e nevojshme gjatë rundit të dytë të bisedimeve të drejtpërdrejta në Stamboll të hënën, më 2 qershor", tha ministri i Jashtëm rus, Sergei Lavrov, në një deklaratë më 28 maj. Lavrov tha se memorandum i do të shpjegojë pikëpamjet e Rusisë "për të gjitha aspektet e kapërcimit në mënyrë të besueshme të shkaqeve rrënjësore të krizës".

Medinsky, shkencëtar politik rus dhe ish-ministër i Kulturës, udhëhoqi ekipin negociator të Rusisë më 16 maj gjatë rundit të parë të bisedimeve të drejtpërdrejta që nga fillimi i pushtimit të plotë të Ukrainës më shumë se tre vjet më parë. Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, bisedoi me Lavrovin dhe përshëndeti këmbimin e të burgosurve gjatë fundjavës, tha zëdhënësja Tammy Bruce në një deklaratë. "Sekretari përsëriti thirrjet e presidentit Trump për dialog konstruktiv dhe në mirëbesim me Ukrainën si rruga e vetme për t'i dhënë fund kësaj lufte", tha Bruce. Presidenti amerikan Donald Trump paralajmëroi më 28 maj se do të përcaktojë brenda "rreth dy javëve" nëse Putin është serioz për t'i dhënë fund luftës. "Do të zbulojmë nëse po na zvarrit apo jo, dhe nëse po, atëherë do të reagojmë ndryshe. Por, kjo do të kërkojë rreth një javë e gjysmë, dy javë", tha Trump për gazetarët në Shtëpinë e Bardhë.

Franca ndalon pirjen e duhanit në shumicën e hapësirave publike

PARIS, 30 MAJ - Qeveria franceze ka shpallur një ndalim të ri të rreptë për duhanpirjen në shumicën e vendeve publike, në përpjekje për ta mbrojtur shëndetin e qytetarëve, veçanërisht të fëmijëve. Sipas vendimit të fundit, ndalimi do të zbatohet në të gjitha hapësirat ku ka gjasa të ketë të pranishëm fëmijë,

përfshirë plazhet, parqet, kopshtet publike, zonat përreth shkollave, stacionet e autobusëve dhe terrenet sportive. Kjo masë vjen si pjesë e një fushate më të gjerë kombëtare për t'i luftuar pasojat e dëmshme të duhanit dhe për të krijuar një mjedis më të shëndetshëm publik, shkruan

BBC. Ministrja e Shëndetësisë, Catherine Vautrin, theksoi rëndësinë e këtij vendimi, duke deklaruar se "duhani duhet të zhdukët aty ku ka fëmijë. Është detyrimi ynë t'i mbrojmë ata nga ndikimet e dëmshme të pirjes së duhanit dhe nga ekspozimi ndaj tymit të dorës së dytë".



KOMUNAT PO PËRBALLEN ME NJË RITJE TË LARTË TË SHPENZIMEVE NGA OBLIGIMET GJYQËSORE DHE PËRMBARIMORE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 30 MAJ - Instituti GAP ka publikuar raportin “Në kërkim të zgjidhjes: Problemet përmbarimore në komuna”. Sipas këtij raporti, komunat e Kosovës po përballen me rritje të lartë të shpenzimeve nga obligimet gjyqësore dhe përmbarimore. “Gjatë periudhës 2022-2024, komunat kanë paguar mbi 163 milionë euro për këto obligime. Si rezultat, disa prej tyre janë detyruar të kërkojnë mbështetje financiare nga qeveria qendrore, ndërsa të tjera kanë qenë të detyruara të pezullojnë ose të heqin dorë nga projektet e planifikuara për investime kapitale. Shpenzimet përmbarimore janë rritur ndjeshëm në të gjitha komunat, pavarësisht madhësisë së tyre, që dëshmon për përhapjen e gjerë të këtij problemi”, theksohet nga GAP-i. Ky raport thekson se obligimet përmbarimore nuk kanë rrjedhur vetëm nga kontrata

kolektive në arsim, por edhe nga marrëveshje të ngjashme në shëndetësi. “Gjithashtu, gjatë periudhës së fundit ka ndikuar edhe një vendim i Qeverisë së Kosovës i vitit 2008, i cili parasheh pagesë shtesë për të punësuarit në sektorin e arsimit, bazuar në nivelin e kualifikimit. Përveç shërbyesve publik në arsim dhe shëndetësi, kompensime nga gjykata po kërkojnë dhe realizojnë edhe shërbyesit civilë, veçmas për përvojën e punës, shujta, pagesë mbi bazë të inflacionit dhe shpenzime për transport”, thuhet në raport, duke shtuar se gjatë vitit 2024, një pjesë e konsiderueshme e komunave kanë pasur shpenzime përmbarimore më të larta se të hyrat vetjake apo investimet kapitale. Po ashtu, sipas raportit në fjalë, komunat po përballen edhe me një rritje të vazhdueshme dhe të lartë të obligimeve të reja (detyrime kontigjente) të paraqitura në gjykata, që arrijnë rreth 208 milionë euro. “Këto përfaqësojnë pretendime



financiare që qytetarët dhe palë të tjera kanë ndaj komunës, e që kryesisht ndërlidhen me projekte kapitale. Përballja me barrën e obligimeve përmbarimore kërkon një reagim të koordinuar ndërmjet pushtetit lokal dhe atij qendror. Meqenëse shumica e këtyre obligimeve burojnë nga vendime, kontrata dhe ligje të

filluara nga niveli qendror, Instituti GAP rekomandon që Qeveria e Kosovës të marrë përsipër ekzekutimin e pagesave rreth vendimeve gjyqësore; të bëhet rishikimi i Ligjit për Pagat në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese për përvojën e punës; dhe qartësimi i statusit të vendimit

të qeverisë të vitit 2008 lidhur me kualifikimet e mësimeve. Po ashtu, për çdo vendim apo ligj të ardhshëm që mund të krijojë barrë financiare për komunat, ato duhet të përfshihen në të gjithë procesin e negociimit dhe përmbytjes së tyre”, është thënë në raportin e GAP-it.

MBRETËRIA E BASHKUAR SHPREH SHQETËSIM PËR MBYLLJEN E INSTITUCIONEVE NË VERI

PRISHTINË, 30 MAJ - Ambasadori i Mbretërisë së Bashkuar në Organizatën për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Neil Holland, ka shprehur shqetësim për mbylljen e ndërtesave dhe institucioneve në veri të Kosovës që funksiononin sipas sistemit të Serbisë. Sipas një njoftimi të publikuar në uebfaqen e qeverisë britanike lidhur me raportin e shefit të misionit të OSBE-së në Kosovë për gjashtë muajt e fundit, Holland tha se është urgjente që Kosova ta formojë qeverinë e re pas zgjedhjeve të shkurtyt që tha se u mbajtën në mënyrë paqësore. “Jemi veçmas të shqetësuar me natyrën e pakoordinuar të mbylljes së institucioneve dhe ndërtesave në veri të Kosovës që ofrojnë shërbime vitale për serbët e Kosovës dhe komunitetet e tjera



joshumicë. Mbretëria e Bashkuar vazhdon ta inkurajojë Qeverinë e Kosovës që të sigurohet që komunitetet joshumicë të mund të luajnë rol të barabartë në të ardhmen e shtetit dhe t'i respektojnë zotimet e Kosovës si një shtet gjithëpërfshirës dhe shumetnik”, tha ai. Kosova nisi mbylljen e

institucioneve serbe në fillim të vitit 2024. Fillimisht u mbyllën organet e përkohshme komunale, Banka Kursimore e Postës, Posta e Serbisë, Fondi për Sigurim Pensional dhe Shëndetësor, qendrat për punë sociale, ndërmarrjet publike dhe institucione të ngjashme. Në valën e fundit të mbylljes së

institucioneve që funksionojnë në sistemin e Serbisë janë përfshirë edhe salla sportive, biblioteka të qytetit, muzeu i qytetit në Mitrovicën e Veriut, Instituti për Kulturë, Rini, Sport dhe Shërbime të Specializuara, si dhe Shoqëria Kulturo-Artistike “Kosovski Bozhur”. Ambasadori Holland, po ashtu, foli edhe për dhunën në veriun e Kosovës, duke përmendur sulmet ndaj pjesëtarëve të KFOR-it më 29 maj 2023 në Zveçan dhe sulmin e armatosur nga një grup i serbëve kundër Policisë së Kosovës në Banjskë shtatorin e po atij viti. “Ne vazhdojmë t'i bëjmë thirrje Serbisë që të bashkëpunojë plotësisht lidhur me përpjekjet që të gjithë përgjegjësit për sulmin ndaj pjesëtarëve të KFOR-it dhe në Banjskë të mbahen përgjegjës dhe ta

përmbushë zotimin për bashkëpunimin në hetimin për sulmin në kanalin e Ibër Lepencit”. Për sulmin në Banjskë dhe në Ibër-Lepenc, Kosova ka fajësuar Serbinë, por Beogradi ka mohuar përgjegjësinë. Ambasadori britanik kërkoi që Kosova dhe Serbia të angazhohen në dialogun e ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe t'i zbatojnë obligimet, përfshirë themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog për normalizim që nga viti 2011. Palët kanë arritur një sërë marrëveshjesh, por BE-ja ka thënë se pak prej tyre janë zbatuar. Palët, po ashtu, nuk kanë zhvilluar dialog në nivel politik që nga shtatori i vitit 2023, pas sulmit në Banjskë.

Haradinaj: Kushdo që voton për qeverinë Kurti 3 është argat i Serbisë

Prishtinë, 30 maj - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka bërë një deklaratë të ashpër ndaj Lëvizjes Vetëvendosje, e udhëhequr nga Albin Kurti. Sipas Haradinajt, kushdo që ndihmon në formimin e qeverisë Kurti 3 është “argat i Serbisë dhe Rusisë”. “Sa i përket qeverisë,

unë jam i bindur: kushdo që e ndihmon qeverinë Kurti 3, është argat i Serbisë dhe Rusisë. Këtë nuk e ndryshoj. Është serioze”, ka thënë Haradinaj në emisionin “Debat Plus” në RTV Dukagjini. Haradinaj ka drejtuar akuza ndaj kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, edhe lidhur me politikën energjetike të qeverisë

dhe vendimin për liberalizimin e tregut të energjisë elektrike, i cili pritet të hyjë në fuqi më 1 qershor. Haradinaj ka thënë se Kurti ka vepruar për vite me radhë kundër fuqizimit të sektorit energjetik të Kosovës, duke penguar zhvillimin e kapaciteteve të reja prodhuese, fillimisht me qymyr e më pas me gaz.





POLICIA E KOSOVËS, PLAN OPERATIV PËR PARANDALIMIN E NGACMIMEVE SEKSUALE NË VERI

Pjesë e planit operativ është që në pesë rrugët kryesore në Mitrovicën e Veriut të vendosen nga dy policë me kamera në uniformë, që do ta monitorojnë çdo ngacmim të mundshëm ndaj grave

PRISHTINE, 30 MAJ - Autoritetet e Kosovës kanë filluar zbatimin e një plani operativ, mbi bazën e të cilit është formuar një grup pune që do të merret ekskluzivisht me ngacmimin seksual të grave në veriun e Kosovës, ka konfirmuar për Radion Evropa e Lirë (REL) zëvendës drejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani. “Në grupin e punës janë përfshirë policia për rendin dhe qetësinë publike, pjesëtarë të policisë kufitare, një përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Brendshme, ndërsa grupi do të monitorohet nga Inspektorati Policor i Kosovës dhe EULEX-i [Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit]”, ka thënë Elshani.

Më 14 maj Radio Evropa e Lirë raportoi për denoncimet gjithnjë e më të shpeshta për ngacmime seksuale ndaj grave në komunat me shumicë serbe në veri të Kosovës. Gratë që kanë pohuar se kanë përjetuar këto përvoja të pakëndshme kanë dëshmuar për REL-in për frikën dhe zemërimin që ndiejnë, por edhe për mungesën e besimit në institucionet që, sipas tyre, nuk kanë reaguar në mënyrë adekuate. Më pas, ministrja në detyrë e Drejtësisë e Kosovës, Albulena Haxhiu, më 23 maj vizitoi Mitrovicën e Veriut për të biseduar për këtë çështje me përfaqësues të policisë dhe të prokurorisë. “Çdo raportim për ngacmim seksual dhe dhunë,

pavarësisht etnisë apo vendndodhjes së viktimës do të trajtohet me profesionalizëm”, ka shkruar ajo në Facebook. Haxhiu u ka bërë thirrje të gjitha grave të cilat përjetojnë ngacmim seksual që rastet t’i raportojnë menjëherë në institucionet përkatëse. Sipas Kodit Penal të Kosovës, ngacmimi seksual është çdo “formë e sjelljes së padëshiruar verbale, joverbale ose fizike të natyrës seksuale, me qëllim të cenimit të dinjitetit apo që cenon dinjitetin e personit, dhe krijon një mjedis i cili është objektivisht frikësues, armiqësor, degradues ose poshtërues”. Dënimi për këtë veprë penale mund të jetë me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Gratë në veri të Kosovës deri më tani zakonisht nuk i kanë raportuar rastet e ngacmimit seksual sepse, sipas tyre, nuk kanë besim në polici. Elshani ka thënë për REL-in se këtë vit janë hapur tri raste të ngacmimit seksual, por në disa raste policia nuk ka pasur prova

të mjaftueshme përpara prokurorisë. Shpresa është që plani operativ të jetë i suksesshëm dhe që të mos ketë më nevojë të raportohen raste të tilla.

Çfarë parashikon saktësisht plani operativ?

Sipas Elshanit, një pjesë e planit operativ është që në pesë rrugët kryesore në Mitrovicën e Veriut të vendosen nga dy policë me kamera në uniformë, që do ta monitorojnë çdo ngacmim të mundshëm ndaj grave. “Njëri ose të dy policët flasin gjuhën serbe, pika statike është në Lagjen e Boshnjakëve [një lagje shumëetnike në Mitrovicën e Veriut], ndërsa gjatë natës angazhohen edhe hetues civilë. Do të ndalohen të gjithë personat e dyshimtë, ose ata që ngasin vetura me xhama të errët”, ka treguar Elshani. Ai ka theksuar se policia është e pranishme gjatë gjithë kohës në rrugët e komunave në veri të

Kosovës, por se me planin e ri operativ është nisur me propozim të drejtorit të përgjithshëm të policisë, Gazmend Hoxha, për shkak të “aktualizimit të problemit”. Planin operativ do të zgjasë tre muaj, ndërsa pas kësaj periudhe do të shqyrtohet nëse ka nevojë për zgjatje.

“Ngacmimi seksual është problem i gjithë shoqërisë së Kosovës”

Aktivistja shumëvjeçare për të drejtat e grave nga Mitrovica e Veriut, Ruzhica Simiq, ka thënë për REL-in se plani operativ është një “fillim pozitiv” për parandalimin e dhunës seksuale në veri të Kosovës, por se Policisë së Kosovës i duhet trajnim në këtë fushë. “Ngacmimi seksual është një problem në të gjithë Kosovën. Këtu, [në veri], kjo veprë penale lidhet me aspektin etnik, pra kryesisht preken gratë serbe, por gjithashtu preken edhe

SHOQËRIA CIVILE THOTË SE VETËVENDOSJA E KA BARRËN KRYESORE NË KRIZËN AKTUALE

Kanë kaluar më shumë se tre muaj pas zgjedhjeve dhe ende nuk kemi Kuvend të konstituuar dhe institucione funksionale. Sot (e shtunë) deputetët e Kuvendit të Kosovës do të mbledhen sërish për herën e 24 për të bërë një përpjekje të re për ta konstituuar përbërjen e nëntë parlamentare të dalë nga zgjedhjet e shkurtit. Dështimet e njëpasnjëshme po ndodhin pavarësisht prej thirrjeve brenda dhe jashtë vendit për të lëvizur përpara për krijimin e institucioneve. Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje e ka barrën kryesore në krizën aktuale. Ai ka thënë se nëse askush nuk ndryshon qasje, edhe zgjedhjet e reja do ta prodhojnë të njëjtën krizë

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 30 MAJ - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar për herë të 23-të radhazi ta konstituojnë përbërjen e nëntë parlamentare të dalë nga zgjedhjet e shkurtit. Dështimi për ta bërë Kuvendin e ri ka shqytur vendin në një ngërç politik. Deputetët sërish sot (e shtunë), në orën 11:00, do të mbledhen për herën e 24 për ta konstituuar përbërjen e nëntë parlamentare. Më 29 maj ligjbërësit refuzuan për të trembëdhjetën herë rresht ta formonin një komision për mbikëqyrjen e një votimi të fshehtë për kreun e ri të organit ligjvënës.

Çështja e votimit të fshehtë që u propozua më 1 maj nga kryesuesi i seancës, Avni Dehari, pasi e propozuara e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, nuk arriti në disa votime t'i merrte 61 votat e nevojshme për t'u konfirmuar në këtë post - është dërguar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga partitë që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë. Ato thonë se është jokushtetuese mënyra se si LV-ja po tenton që kryeparlamentari të votohet përmes formës së fshehtë dhe i kanë kërkuar Kushtetueses të marrë "një masë të përkohshme për ndalim të mbajtjes së seancave, derisa me prioritet ta trajtojë këtë lëndë dhe ta marrë

një vendim".

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe refuzuan sërish, në vazhdimin e seancës konstituive më 29 maj, ta propozonin një përfaqësues që do ta siguronte mbarëvajtjen e votimit të fshehtë.

Eugen Cakolli nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka reaguar të premten për situatën e krijuar rreth konstituimit të Kuvendit. Ai ka shkruar në rrjetin social "Facebook" se kur llogaridhënia trajtohet si monolog kundër pushtetit, e jo si standard ndaj kujtdo që mban mandat publik, nuk po mbrohet demokracia, por komoditeti politik. "Si shoqëri civile, nuk jemi këtu për të dekoruar retorikën e askujt. Ne flasim kur shteti ngec dhe kur përfaqësuesit politikë - pozitë apo opozitë - nuk ushtrojnë funksionet e tyre. Mbi të gjitha, është e padrejtë të thuhet se kemi heshtur për katër vite, kur shpesh kemi qenë zëri i vetëm në thirrjet për transparencë, integritet dhe zgjidhje", ka shkruar ai.

Cakolli ka thënë se partia e Albin Kurtit e ka barrën kryesore për krizën aktuale. "Po, LV-ja e ka barrën kryesore në krizën aktuale - këtë e kemi artikuluar hapur, pa ekuivok dhe vazhdimisht! Por, jo, kjo nuk do të thotë se të tjerët kanë luksin e papërgjegjësive. Ideja se opozita

është e paprekshme nga kritika, se kriza është 'monopol' i pushtetit, apo se ndarja e përgjegjësive është padrejtësi, është kundër çdo logjike institucionale. Në një realitet pa shumicë, çdo refuzim sistematik i dialogut dhe i çdo formule zgjidhjeje është pjesë e bllokadës, pavarësisht pozitës që mban. Nëse askush nuk ndryshon qasje, edhe zgjedhjet e reja do të prodhojnë të njëjtën krizë. Me ndryshimin e vetëm, që do të shpenzojmë miliona euro për të larë linjat e kuqe apo retorikën ndaj të tjerëve. Kur Kuvendi nuk funksionon dhe shteti është në pauzë, askush që mban mandat publik nuk është pa përgjegjësi. Dhe askush nuk është i përjashtuar nga pyetja më e thjeshtë publike: çka je duke bërë për zgjidhje?", ka thënë Cakolli.

Rreth 60 organizata të shoqërisë civile ditë më parë kanë theksuar se kriza institucionale që pasoi zgjedhjet e 9 shkurtit 2025 ka kaluar çdo kufi të tolerueshëm dhe po dëmton jo vetëm Kuvendin, por edhe funksionimin e gjithë sistemit demokratik dhe institucional të vendit. Sipas këtyre organizatave, Kuvendi jofunksional po e pamundëson miratimin e ligjeve të rëndësishme dhe vendimeve strategjike që ndikojnë drejtpërdrejt në jetën e qytetarëve dhe qytetareve, duke

rrezikuar stabilitetin institucional, zhvillimin ekonomik dhe besimin qytetar në përfaqësim demokratik. "Bllokada aktuale është duke vonuar e rrezikuar pranimin e fondeve nga Plani i Rritjes së BE-së, në kohën kur masat e vendosura nga BE dhe pezullimi pothuajse i tërësisht i fondeve amerikane kanë reduktuar ndjeshëm mbështetjen financiare për Kosovën", është thënë në reagimin e organizatave të shoqërisë civile. Po ashtu, organizata të shoqërisë civile përmes një performance kanë protestuar më 27 maj para Kuvendit të Kosovës në lidhje me moskonstituimin e institucionit ligjvënës.

120 karriqe të zbrazëta ishin vendosur përballë hyrjes së Kuvendit, një për secilin deputet që, për më shumë se tre muaj, ka dështuar ta përmbushë detyrimin më bazik të mandatit të tij, atë të përfaqësimit të qytetarëve përmes një Kuvendi funksional, përfaqësues dhe llogaridhënës.

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se bllokada po vazhdon edhe mbi tre muaj e gjysmë pas zgjedhjeve për shkak të kryeneçësisë politike të Albin Kurtit. "Ka kaluar një muaj e gjysmë prej kur ka filluar tentimi për ta konstituuar Kuvendin dhe mbi tre muaj e gjysmë prej kur janë mbajtur zgjedhjet,

fatkeqësisht bllokada e iniciuar dhe e mundësuar nga Lëvizja Vetëvendosje po vazhdon në Kuvendin e Kosovës. Ne as sot s'kemi institucione dhe duket që s'ka as interesim e asnjë veprim që do ta nxirrte Kosovën nga situata e rëndë në të cilën kjo kryeneçësi politike e z. Kurti dhe partisë Vetëvendosje e ka futur vendin tonë. Vërtet është për keqardhje që s'ka asnjë reflektim", ka thënë Krasniqi.

Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të agjendës së seancës konstituive: raportin e Komisionit të Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe atë të Betimit të Deputetëve. Procesi ka ngecur te pika e tretë: te zgjedhja e kryeparlamentarit.

Haxhiu e LV-së po konsiderohet figurë përçarëse nga dy parti parlamentare: PDK-ja dhe AAK-ja. Këto dy subjekte kanë kërkuar që LV-ja të propozojë emër tjetër për kryeparlamentar. LDK-ja, ndërkaq, ka thënë se nuk ka vota për asnjë të propozuar të LV-së për pozitën e kryeparlamentarit.

Propozimi për kryeparlamentar është e drejtë ekskluzive e fitueses së zgjedhjeve, LV-së, e cila ngul këmbë se Haxhiu meriton të zgjidhet dhe, ndonëse ka kërkuar marrëveshje politike me partitë e tjera, e ka përjashtuar mundësinë të sjellë kandidat tjetër pos saj.

gratë boshnjake dhe të gjitha gratë e tjera në veri", është shprehur Simiq.

Ajo ka shtuar se duhet kohë për t'i parë rezultatet e planit, dhe vetëm në rast të rezultateve pozitive do të rritet besimi në institucione. Sipas saj, për të pasur më shumë besim të serbëve në institucionet e Kosovës është e nevojshme që bashkëkombësit e tyre të kthehen në polici dhe gjyqësor, institucione të cilat i kanë braktisur në vitin 2022 për arsye politike.

Çfarë thotë EULEX-i?

Misioni i BE-së për sundimin e ligjit në Kosovë - EULEX - në përgjigje për REL-in - ka thënë se është në dijeni për raportimet

mbi ngacmimet seksuale në të gjithë Kosovën, veçanërisht në veri, dhe se i merr shumë seriozisht këto raste.

Një grup organizatash joqeveritare serbe iu drejtua më 12 maj komunitetit ndërkombëtar, veçanërisht EULEX-it, me pyetje nëse po i ndjekin dhe dokumentojnë rastet e ngacmimeve ndaj grave dhe vajzave në veri të Kosovës, dhe "cilat janë hapat konkretë që ndërmarrin kur identifikojnë mangësi sistematike në punën e Policisë së Kosovës në lidhje me mbrojtjen e qytetarëve nga komunitetet joshumicë".

Nga EULEX-i thonë se e kanë pranuar këtë kërkesë të shoqërisë civile, se kanë kthyer përgjigje dhe se kanë përsëritur se "shkelja e të drejtave të

njeriut dhe format e dhunës me bazë gjinore" janë të papranueshme dhe se i dënojnë ashpër. "Ne kemi përsëritur përkushtimin tonë të fortë për të mbështetur institucionet dhe shoqërinë kosovare në përpjekjet e tyre për të çrrënjësuar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, duke kujtuar kapacitetet tona të forta monitoruese dhe rolin këshillëdhënës për të ndihmuar në forcimin e përpjekjeve të Policisë së Kosovës të fokusuara në komunitet", thuhet në përgjigjen e EULEX-it. Organizata joqeveritare "Aktiv" nga Mitrovica e Veriut më 29 maj organizoi një diskutim publik mbi "sfidat e sigurisë dhe besimit", marrëdhëniet ndërmjet Policisë dhe

komunitetit në veri të Kosovës, ku morën pjesë qytetarë, përfaqësues të institucioneve lokale, partive politike dhe organizatave ndërkombëtare. Në këtë diskutim, përfaqësues të komunitetit serb ngritën problemin e ngacmimit seksual verbal dhe shprehën "shqetësim për mosrespektimin e ligjit". "Gjatë diskutimit të hapur, u theksuan sfidat kryesore dhe ndryshimet e nevojshme për të përmirësuar besimin dhe sigurinë në veri të Kosovës", u tha në njoftim. Aktiv shtoi se diskutimi tregoi edhe "nevojën urgjente për forcimin e besimit të ndërsjellë midis Policisë dhe qytetarëve", si dhe për vendosjen e mekanizmave më efikas për raportimin e problemeve.

Çfarë thonë statistikët?

Sipas të dhënave të Policisë së Kosovës, deri më 10 mars 2025 janë raportuar 15 raste të dhunimit në gjithë territorin - krahasuar me 71 raste në vitin 2024 dhe 94 raste në vitin 2023. Gjithashtu, deri më 10 mars janë shënuar 6 raste të sulmeve seksuale, ndërsa vitin e kaluar ishin 71, dhe në vitin 2023 gjithsej 67.

Policia nuk ka sqaruar se në cilat komuna janë regjistruar këto raste.

Sipas Kodit Penal të Kosovës, për këto vepra penale parashihet dënim me gjobë ose me burgim nga 1 deri në 10 vjet.

Lushtaku kujton Kiçinën dhe Halilajn: I qëndruan besnikë betimit për çlirim deri në frymën e fundit

SKENDERAJ, 30 MAJ - Nën kryetari i komunës së Skenderajt, Sami Lushtaku, ka kujtuar dy luftëtarët e lirisë, Rasim Kiçinën dhe Ragip Halilajn. Në “Facebook”, Lushtaku tha se që të dy dëshmorët me armë në dorë i qëndruan besnikë betimit për çlirim deri në frymën e fundit.

“Sot kujtojmë me nder e krenari dy luftëtarë të paepur të lirisë, Rasim Kiçinën dhe Ragip Halilajn, të cilët me armë në dorë i qëndruan besnikë betimit për çlirim deri në frymën e fundit. Trim Rasimi dhe luftëtari i pathyeshëm Ragipi ishin pjesë e atyre brezave që e vendosën

lirinë mbi gjithçka, duke dhënë kontribut të jashtëzakonshëm në radhët e UÇK-së deri në rënien e tyre me 30 maj 1999. Lavdi e përjetshme Rasim Kiçinës, Ragip Halilajt dhe gjithë dëshmorëve të rënë për lirinë e Kosovës!”, ka shkruar Lushtaku.



QEVERIA E LUKSEMBURGUT RRIT SHUMËN E FINANCIMIT PËR KOSOVËN NË 50 MILIONË EURO

PRISHTINË, 30 MAJ - Zëvendëskryeministri i parë në detyrë, Besnik Bislimi, ka pritur të premten në takim ambasadorin e Luksemburgut në Kosovë, Eric Dietz, së bashku me drejtorin e Departamentit për Bashkëpunim Dypalësh, Rene Lauer, në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Luksemburgut. Gjatë takimit zëvendëskryeministri falënderoi ambasadorin dhe shtetin e Luksemburgut për bashkëpunimin dhe përkrahjen e vazhdueshme që i kanë dhënë Kosovës ndër vite. Ai theksoi rëndësinë e këtij partneriteti për forcimin e institucioneve dhe avancimin e reformave për zhvillim të qëndrueshëm. Ambasadori dhe drejtori i

bashkëpunimit shprehën mirënjohjen rreth angazhimit dhe rezultateve të dukshme të institucioneve të Kosovës, ndër të cilat, disa janë arritur përmes projekteve në kuadër të ndihmës dhe bashkëpunimit bilateral. Në takim u diskutua mbi rëndësinë e harmonizimit të mëtejshëm të prioritetëve dhe projekteve të përbashkëta, me qëllim të thellimit të mëtutjeshëm të bashkëpunimit dypalësh. Një ndër pikat e diskutimit ishte edhe marrëveshja e re dypalëshe në kuadër të së cilës Qeveria e Luksemburgut ka rritur shumën e financimit për Kosovën në 50 milionë euro, nga 35 milionë sa ka qenë ajo e 2023-2026. Kjo marrëveshje,



për vitet 2026-2030, pritet të nënshkruhet në takimin e dhjetë bilateral që do të mbahet në Luksemburg gjatë muajit korrik të këtij viti. Edhe kjo marrëveshje si ajo paraprake synon të kontribuojë në forcimin e administratës publike, zhvillimin e kapitalit njerëzor dhe ndërtimin e një shoqërie të qëndrueshme. Ndërsa fushat prioritare të bashkëpunimit do të jenë: arsimit, shëndetësisë, inovacioni, digjitalizimi, siguria kibernetike, si dhe fusha të tjera me rëndësi strategjike për zhvillimin e vendit. Gjatë muajve në vijim institucionet do të punojnë në identifikimin e projekteve dhe detajizimin e tyre.

ARBËR ISMAJLI, KANDIDAT I LDK-së PËR KRYETAR TË GJILANIT



GJILAN, 30 MAJ - Arbër Ismajli është votuar nga Dega e LDK-së në Gjilan për kryetar të komunës në zgjedhjet lokale të cilat do të mbahen në tetor. “Me nderin më të madh pranoj nominimin si kandidat për kryetar të ardhshëm të Komunës së Gjilanit nga strukturat e LDK-së. Faleminderit kryetarit të LDK-së, dr. Lumir Abdixhiku dhe kryetarit të degës në Gjilan, Lutfi Haziri për besimin dhe mbështetjen e palëkundur. Mirënjohje të veçantë për çdo nëndegë në çdo pëllëmbë të Gjilanit, aty ku zëri juaj më obligon dhe më jep përgjegjësi t’ju përfaqësoj”, ka shkruar

Ismajli në “Facebook”. Ai ka thënë se ky është një besim që e obligon dhe e motivon për punë e përkushtim të pakompromis. “Gjilani ka nevojë për bashkim, për vizion të qartë dhe për energji të reja që sjellin ndryshim. Ftoj çdo qytetar të Komunës së Gjilanit, anë e kënd, që të bëhen pjesë e kësaj rruge të përbashkët. Bashkë do ta kthejmë Gjilanin në rrugën e zhvillimit, dinjitetit dhe përparimit. Koha e ndarjeve ka kaluar dhe tani është koha e bashkimit për qytetin tonë. Do të jem zëri dhe fuqia e secilit që beson në një të

ardhme më të mirë. Ky nominim është përgjegjësi e madhe dhe premtim për punë të pandalshme. Bashkë, me unitet dhe vizion të qartë, do ta kthejmë Gjilanin aty ku e meriton. Na pret një rrugë sfiduese, por me energji të reja ku me punë dhe vendosmëri do t’ia dalim bashkë. Ju bëj thirrje të gjithë qytetarëve, të gjitha strukturave dhe gjeneratave që të bëhemi bashkë. Gjilani meriton shumë më shumë dhe ne bashkë këtë rrugëtim do ta bëjmë realitet. Fitorja është e përbashkët, për Gjilanin që e duam të gjithë”, ka thënë Ismajli.

Fillon ndërtimi i objektit të ri të shkollës “Nuhi Gashi” në Bradash

PODUJEVË, 30 MAJ - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, së bashku me kryeministrin në detyrë, Albin Kurti, ministren në detyrë të Arsimit, Arbërie Nagavci, drejtorin Avni Fetahu, deputetë, drejtorë, asamblistë dhe qytetarë, mori pjesë në

ceremoninë solemne të vënies së gurthemelit të shkollës “Nuhi Gashi” në Bradash, një kërkesë e kahershme e banorëve të këtij fshati. “Objekti i ri, me një vlerë prej mbi 624 mijë euro dhe një sipërfaqe prej 1,330 m², do të ketë 10 klasa, kabinetet e

nevojshme, hapësira për administratë si dhe tualete moderne, të përshtatshme edhe për fëmijët me nevojë të veçanta. E gëzofshin nxënësit, mësimmshënësit dhe i gjithë komuniteti i Bradashit këtë projekt”, ka thënë kryetari Bulliqi.



Presidentja Osmani dhe gjeneral Jashari vizitojnë pjesëtarët e FSK-së në ushtrimin "Defender Europe 25"

PRISHTINË, 30 MAJ - Me rastin e fillimit të ushtrimit shumëkombësh "Defender Europe 25" (DE/IR25), presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani-Sadriu, së bashku me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtnant Bashkim Jashari, vizituan Post-

Komandën Taktike të Divizionit të 28 të Ushtrisë Amerikane, Kontrollin e Lartë të Ushtrimit dhe Kampin Taktik. Gjatë vizitës ata u informuan për rolin dhe kontributin e FSK-së në kuadër të DE25, si dhe për nivelin e bashkëpunimit me partnerët dhe aleatët ndërkombëtarë.

Në përmbyllje, presidentja Osmani dhe gjeneral Jashari i përgëzuan pjesëtarët e FSK-së dhe ushtarakët aleatë për përkushtimin dhe profesionalizmin e dëshmuar, duke e vlerësuar ushtrimin si një mundësi e rëndësishme për ngritjen e kapaciteteve dhe gatishmërisë operacionale të FSK-së.



MINISTRIA E SHËNDETËSISË THOTË SE PO BËN PËRKUSHTIM TË VAZHDUESHËM NË LUFTËN KUNDËR DUHANIT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 30 MAJ - Me rastin e shënimit të Ditës Botërore Kundër Duhanit, Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike, ka mbajtur konferencë për medie. Në këtë konferencë mori pjesë edhe ministri i Shëndetësisë në detyrë, Arben Vitia, i cili tha se 31 maji shënon Ditën Botërore pa Duhan, një moment reflektimi dhe veprimi për të adresuar një nga sfidat më serioze të shëndetit publik - përdorimin e duhanit dhe ndikimin e industrisë së tij në politikat dhe shëndetin tonë kolektiv.

Po ashtu, ministri në detyrë Vitia tha se kontrolli i duhanit është sfidë komplekse jo vetëm për Kosovën, por kudo në botë. Megjithatë, sipas tij, përkundër sfidave, rezultatet nuk kanë munguar. "Nga të arriturat e prekshme pa dyshim është edhe miratimi dhe zbatimi i Udhëzimit Administrativ për Vërejtjet e Kombinuara Shëndetësore në pakot e duhanit, që shënon një prej masave më të rëndësishme në edukimin vizual të konsumatorëve për dëmet shkatërruese të konsumimit të duhanit. Zbatimin e ligjit e ka bërë më të lehtë fuqizimi i



kapaciteteve inspektuese, përmes rekrutimit të rreth 30 inspektorëve të rinj shëndetësorë. Gjithashtu, rritja e akcizës në 65 euro për kg, sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është një tjetër sinjal që politikat fiskale po japin efekt", tha ministri Vitia.

Më tutje, ai shtoi se Ministria e Shëndetësisë është duke punuar për përditësimin dhe fuqizimin e kornizës ligjore dhe mbrojtjen nga ndikimi i industrisë përmes Projektligjit të ri gjithëpërfshirës, duke adresuar çështjen e produkteve të reja të duhanit dhe produkteve të ndërlidhura

që nuk janë të rregulluara mjaftueshëm me ligjin ekzistues. Ndërsa përfaqësuesi i Qendrës për Avokim dhe Zhvillim, Arben Lila, me rastin e shënimit të Ditës Botërore Kundër Duhanit, tha se janë bashkuar për të dërguar një mesazh të fuqishëm

dhe të përbashkët: T'i mbrojmë të rinjtë nga ndikimi i industrisë së duhanit dhe të ndërtojmë një të ardhme të lirë nga varësia ndaj nikotinës. "Kosova nuk qëndron jashtë këtyre zhvillimeve, prandaj KADC, me mbështetjen e partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë, ka iniciuar fushatën gjithëpërfshirëse: 'T'i heqim Maskën Ndikimit - Të rinjtë për një të ardhme pa duhan'. Përmes kësaj fushate, të rinjtë janë angazhuar në monitorimin e përmbajtjes digjitale të industrisë së duhanit, kanë ndarë gjetje përmes sfidës #ZbulojëTaktiken, dhe po ndihmojnë në ndërtimin e një presioni pozitiv publik për ndryshim të politikave", tha Lila. Po ashtu, përfaqësuesi i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës, dr. Faik Hoti, shtoi se IKShPK-ja, përmes kërkimeve dhe hulumtimeve shkencore, siguron bazën shkencore dhe praktike për politikat kundër duhanit në vend. Prandaj, në këtë drejtim, IKShP-ja prodhon të dhënat zyrtare mbi përdorimin e duhanit - përmes studimeve si GYTS 1 dhe GYTS 2 si dhe STEPS 2011 dhe 2019, përmes të cilave ka dokumentuar rënien e prevalencës së përdorimit të duhanit nga 28.4 % (2011) në 25.7 % (2019), që tregon një progres të konsideruar.

Ndalohe zyrtarë publikë për lëshimin e patentëshoferëve në mënyrë të kundërligjshme

PRISHTINË, 30 MAJ - Autoritetet në Kosovë kanë njoftuar se dhjetë zyrtarë publikë janë ndaluar për 48 orë, nën dyshime se kanë marrë ryshfet në këmbim të pajisjes me patentë shoferë të kandidatëve.

Policia e Kosovës tha se gjatë aksionit të kryer në rajonin e Prishtinës, Gjilanit dhe Gjakovës ka arrestuar 11 persona. Më pas, një prej tyre e ka liruar në procedurë të rregullt.

Prokuroria Themelore në Prishtinë më pas njoftoi se brenda afatit ligjor, prokurori i rastit do të kërkojë që ndaj të pandehurve të shqiptohet masa e paraburgimit. "Personat e

ndaluar janë zyrtarë publikë të cilët dyshohen se me qëllim që kandidatët të pajisen me patentë shofer kanë kërkuar para ryshfet, gjatë së cilës u kanë mundësuar atyre të pajisen me patentë shofer në mënyrë të kundërligjshme", tha Prokuroria.

Ndërkaq, në njoftimin e policisë u tha se gjatë aksionit janë kontrolluar dhjetë lokacione në rajonin e Prishtinës, Gjilanit dhe Gjakovës për këtë rast, përfshirë shtëpi private, zyra rajonale të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe biznese me veprimtari të autoshkollës, më

29 maj.

Sipas policisë, rasti është hetuar për disa muaj dhe janë siguruar prova se të arrestuarit kanë kryer veprat penale: keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, pranim të ryshfetit në sektorin privat, ushtrim ndikimi dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve.

Autoritetet njoftuan se gjatë kontrollit janë sekuestruar prova, përfshirë një pushkë AK47, dy revole, fishekë të kalibrave të ndryshme, para të gatshme (16.145 euro dhe 6660 franga zvicerane), telefona mobilë, kompjuterë, USB dhe



dokumente të tjera të rëndësishme për rastin. Edhe në të kaluarën autoritetet kishin arrestuar zyrtarë të

Ministrisë së Infrastrukturës për pajisjen e kandidatëve me patentë shoferë në këmbim të përfitimeve materiale.

ÇFARË ËSHTË PUNA E FABRIKËS PËR MBETJE SHTAZORE?

Ministri në detyrë i Bujqësisë në Kosovë është vënë në qendër të hetimeve mbi dyshimet se janë bërë shkelje rreth vënies në funksion të një fabrike për përpunimin e mbetjeve shtazore. Për çfarë, saktësisht, bëhet fjalë?

PRISHTINË, 30 MAJ - Ministri në detyrë i Bujqësisë, Faton Peci, dhe kryeshefi i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV), Bekim Hoxha, këtë javë u morën në pyetje nga prokurorët, mbi dyshimet për keqpërdorim të detyrës zyrtare në një rast që ka të bëjë me funksionalizimin e një fabrike për trajtimin e mbetjeve shtazore.

Nga Prokuroria Speciale e Kosovës - me kërkesë të së cilës u bënë bastisje në Ministrinë e Bujqësisë, në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë (ABZH), në AUV dhe në zyrën e një kompanie private - thanë të mërkurën për Radion Evropa e Lirë se hetimet po vazhdojnë.

Në Parkun Industrial, në Drenas, në dhjetor të vitit 2019 kishte përfunduar ndërtimi i fabrikës që parashihej të përpunonte dhe të asgjësonte nënproduktet shtazore. Ky projekt, në vlerë të 7.7 milionë eurove, ishte realizuar nga AUV-ja, me bashkëfinancimin e Komisionit Evropian (KE).

Por, funksionalizimi i fabrikës nisi tek në vitin 2024, kur edhe u hap thirrja për kompanitë që të aplikonin për ta marrë në

shfrytëzim fabrikën, dhe për të nisur punën në grumbullimin dhe kategorizimin e nënprodukteve shtazore.

U raportua se kompania kosovare LIP KS & IT SH.PK. u përzgjodh për ta funksionalizuar fabrikën, me afat operimi për 20 vjet - deri në vitin 2044.

U tha se kjo kompani ishte regjistruar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) vetëm 5 ditë pas thirrjes për aplikim.

Kësisoj dyshohet se nuk u përmbushën kriteret që fituesi i kontratës të kishte përvorë 12 deri në 15-vjeçare në përpunimin e nënprodukteve shtazore, dhe të dëshmonte se në tre vjetët e fundit kishte përpunuar 20 mijë tonë të nënprodukteve shtazore.

Prokurori i Prokurorisë Speciale, Admir Shala, tha më 27 maj se “hetimi është duke u zhvilluar në lidhje me dyshimet për dhënien me qira të kësaj fabrike”.

Një ditë më herët, Partia Demokratike e Kosovës (PDK) denoncoi Ministrinë e Bujqësisë për dhënien me qira të fabrikës pa ankand publik.

Kjo parti tha se kompania fituese



do të paguajë qira “vetëm 30 mijë euro në vit, për një periudhë 20-vjeçare, ndërkohë që përfiton subvencione mbi 3.2 milionë euro në vit”. U raportua se aksionarë të kompanisë fituese janë një kosovar, si drejtor menaxhues i saj, dhe dy kompani të tjera, njëra me adresë në Mal të Zi e tjetra në Itali. Kompania me adresë në Podgoricë thuhet të jetë në pronësi të një kompanie tjetër, me seli në Serbi.

Çfarë deklaroi ministri që po dyshohet për rastin?

Faton Peci nuk sqaroi se pse po hetohet nga Prokuroria, ndonëse tha se është i gatshëm të bashkëpunojë me institucionet e drejtësisë. “Është në interes të zbardhet çdo detaj për pretendimet që i ka drejtësia. Jam i hapur dhe bashkëpunues për krejt veprimet dhe për aq sa më ka

takuar mua si ministër”, u shpreh ai para gazetarëve, më 29 maj. Në deklaratimet e mëparshme, Peci kishte thënë se vetëm kishte nënshkruar kontratën, siç i takonte në fund të procesit, por se nuk kishte marrë pjesë në asnjë fazë paraprake, dhe kishte mohuar se kishte njohuri për pronësinë e kompanisë fituese.

Duke akuzuar kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale, Pecit i doli në mbrojtje bashkëudhëheqësja e Partisë Guxo, Donika Gërvalla Schwarz. “Inskenim i gërditshëm ky aksioni i sotëm i Blerim Isufajt kundër ministrit Faton Peci, ministrit më shembullor të këtij mandati”, shkroi ajo në “Facebook”.

Atë e mbrojti edhe ministria në detyrë e Drejtësisë. “Nuk ka pasur asnjë ndërhyrje të ministrit Peci”, u shpreh Albulena Haxhiu për mediet, teksa shtoi se ministri në detyrë i Bujqësisë është i hapur të bashkëpunojë me institucionet e

drejtësisë për ta zbardhur “planin kundër tij”.

Cili ishte qëllimi i kësaj fabrike?

Fabrika për përpunimin e mbetjeve shtazore ishte projekt i KE-së, në kuadër të mbrojtjes së mjedisit, me qëllimin që kafshët e ngordhura dhe mbetje të tjera të mos hidheshin nëpër kontejnerë, bashkë me mbeturinat e tjera.

Vite më parë, nga Zyra e Bashkimit Evropian kishin sqaruar se çka parashihej të bëhej me mbetjet e kafshëve në këtë fabrikë: yndyra do të ndahej prej eshtrave dhe pjesëve të tjera, të cilat nuk janë të përdorshme, dhe do të përdorej kryesisht në industrinë e energjetikës, si burim energjie. Parashihej që në fazat e ardhshme të përpunimit ky produkt të përdorej edhe në industrinë kozmetike dhe në industrinë e ushqimit të kafshëve.

PDK-ja NIS BETEJËN LIGJORE PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË ZRRE-së

PRISHTINË, 30 MAJ - Partia Demokratike e Kosovës ka nisur sot betejën ligjore përmes një kundërshtimi administrativ ndaj njoftimit të Zyrës së Rregullatorit për Energji, me të cilin nga data 1 qershor 2025 parashihet largimi i një numri të madh biznesesh nga furnizimi përmes shërbimit universal dhe kalimi i tyre në tregun e lirë të energjisë.

Deputeti i PDK-së, Abelard Tahiri, në një konferencë për medie ka thënë se ky vendim që prek drejtpërdrejt rreth 1 300 biznese dhe mbi 140 mijë punëtorë, përbën një goditje të rëndë ndaj ekonomisë së vendit, duke rrezikuar falimentime masive, rritje të papërbalueshme të çmimeve dhe një valë të re inflacioni që godet qytetarët dhe konsumatorët.

“ZrRe ka vepruar pa marrë parasysh reagimet e shoqërisë civile, odave ekonomike dhe organizatave profesionale, dhe pa përmbushur as parakushtet që vetë i kishte përcaktuar për një proces të sigurt dhe të drejtë të liberalizimit të tregut. Ky vendim



është marrë në mungesë të një analize të konkurrencës, si dhe pa konsultim me institucionet përgjegjëse, si Autoriteti Kosovar i Konkurrencës dhe Zyra e Ndihmës Shtetërore. Siç ka vërejtur qartë edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, ky vendim cenon interesat legjitime të një komuniteti të gjerë ekonomik, duke krijuar kushte për një krizë

të re sociale në vendin tonë”, theksoi ai.

PDK i ka bërë thirrje ZRRe-së ta pezullojë menjëherë zbatimin e këtij vendimi, në të kundërtën pas 15 ditësh PDK do ta procedojë në Gjykatën Themelore të Prishtinës, ku do të kërkohet që sa më parë t'i vihet masë e përkohshme zbatimit të tij. “Situata bëhet edhe më

alarmante për shkak të pozitës dominuese të KESCO-s në treg, ndërkohë që shumica e operatorëve të tjerë të licencuar nuk janë prodhues, por vetëm tregtarë të energjisë, që ofrojnë çmime deri në 280% më të larta. Kjo provon qartë se kushtet për një treg të hapur, të drejtë dhe konkurrues nuk ekzistojnë. Prandaj, PDK i bën thirrje ZRRe-

së që të pezullojë menjëherë zbatimin e këtij njoftimi, se ky as vendim nuk është. E kanë lëshuar si njoftim për t'i ikur ballafaqimit ligjor”, theksoi Tahiri.

Ai njoftoi se një nga kompanitë që ka aplikuar për licencim për shitblerje të energjisë është MDA, kompani e themeluar nga shefi i stafit të kryeministrit Albin Kurti, Luan Dalipi. “Luan Dalipi është themelues dhe njëkohësisht ka qenë pronar i kësaj kompanie. Pra, MDA e shefit të stafit të kryeministrit, që sot drejtohet nga Driton Dalipi, ka aplikuar për licencë për furnizim me energji elektrike në vendin tonë. Në njërën anë, kryeministri e dërgon vëllain në Departamentin për Shitblerje të Energjisë Elektrike në KEK dhe në anën tjetër shefi i stafit të kryeministrit kërkon licencë që këtyre kompanive që i kanë qitë në treg të lirë t'i u shesë energji elektrike”, shtoi Tahiri, i cili bëri me dije se PDK gjatë ditës do ta dërgojë edhe kundërshtimin e plotë administrativ kundër aktit real - njoftimit publik mbi liberalizimin e tregut të energjisë elektrike në Kosovë.

NJERIU KRYESOR I KOHËS I BËRI TREMIJË VJET


Nga: Daniel MENDELSON, autor i librit *Odisejada: Ati, i biri dhe një epikë* [An Odyssey: A Father, a Son, and an Epic], i cili së fundmi botoi përkthimin më të ri në anglisht të *Odisesë* / THE NEW YORK TIMES

Figura që rrinte shtrirë në shtratin e spitalit – e heshtur dhe e palëvizshme, me kokën e mbështjellë në fasha dhe krahët e rrjetëzuar nga tubacionet intravenoze dhe të oksigjenit – mezi i ngjante babait tim. E, megjithatë, isha i sigurt se ai ishte ende aty, diku brenda. Ishte janari i vitit 2012 dhe babai im, një shkencëtar kërkimor dhe profesor i shkencave kompjuterike në pension, sapo kishte pësuar një goditje të rëndë në tru, nga e cila, siç na u tha, nuk pritej ndonjë shërim i hairit. Në ditët dhe javët që pasuan, ndër-sa nëna, katër vëllezërit e motrat e mi dhe unë vizitonim repartin e kujdesit intensiv, përpiqeshim të kuptonim lidhjen midis figurës së palëvizshme në shtrat dhe të burrit që kishim njohur. A ekzistonte ndonjë thelb i tij – një “ai” që isha i bindur se ende mund ta ndjeja – që mbetej i pandryshuar, edhe pse gjithçka tjetër kishte ndryshuar?

Çuditërisht, këto ishin të njëjtat pyetje që babai im dhe unë kishim shqyrtuar një vit më herët, në pranverë, kur ai mori pjesë në seminarin e vitit të parë për Odisenë – të cilin unë e ligjëroja (një përvojë që më vonë u bë bazë për një libër timin). Babai, mendimtar racional, ishte goxha skeptik për poemën epike me 12 mijë e 110 vargje të Homerit, për një hero dinak me prirje për mashtime, dredhi dhe gënjeshtër të hapura – një rrëfim aventuresk përplot me gjigantë kanibalë, me përbindështa me shtatë koka dhe nimfa që të kurthonin me dashuri. Por, deri në fund të semestrit, edhe babai im pranoi se poema e Homerit shtroi pyetje rreth asaj se kush jemi dhe si mund të njihemi – pyetje të cilat janë njëkohësisht të thella dhe çuditërisht moderne – ose, siç ka thënë vetë Homeri në vargjet hyrëse, “edhe për kohën tonë.”

Nuk është për t’u çuditur që vepra Odiseja, një gurthemel i kanonit perëndimor dhe pararendëse e kaq shumë zhanresh, nga fantashkenca te komeditë romantike, po përjeton një rikthim në popullaritet. Këtë vit kemi parë një adaptim madhor teatror në Teatrin Amerikan të Repertorit [American Repertory Theater] në Kembrixh të Masaçusetsit, nga dramaturgia feministe Kate

Hamill. Pastaj erdhën jo një, por dy përshtatje të rëndësishme kinematografike: Kthimi [The Return], me regji të Uberto Pasolinit dhe me aktorët Ralph Fiennes e Juliette Binoche në rolet kryesore, si dhe një përshtatje e re që pritet të jepet verën e ardhshme, nga regjisor i Christopher Nolan, me aktorin Matt Damon në rolin e “njeriut me shumë fytyra” – siç e quan Homeri, Odisenë. Ky epitë flet drejtpërdrejt për pyetjen mbi identitetin e shumëfishit dhe ndonjëherë të rrëshqitshëm të heroit. Nëse çdo epokë gjen interesin e vet tek Odiseja, atëherë është pikërisht kjo rrëshqitje të cilën audiencat dhe krijuesit e sotëm e njohin, ashtu të zhytur siç jemi në debate për identitete politike, shoqërore, gjinore dhe seksuale – në një botë që, si ajo e Odisesë, shpesh duket ngatërruese dhe e errët. Poema e komplikon çështjen e identitetit që në fillim. Vargjet hapëse, ku zakonisht poeti shpall subjektin dhe temën, ashikare nuk e përmendin emrin e Odisesë, duke iu referuar atij thjesht si “një burrë”: “Më fol për një burrë, Muzë, që pat shumë rrugë të tërthorta / për t’u endur, pa drejtim”. (Krahasoni me hapjen e epikës tjetër homerike, Iliada, e cila menjëherë tregon për kë është fjala: “Zemërimin – këndo për zemërimin, o Hyjneshë, për të birin e Peleut, Akilin.”) Po kush është ky burrë? Vështirë të thuhet. Më vonë, në fillim të njëjës prej aventurave më të njohura të heroit, Odiseu përdor pseudonimin “Askushi” kur përballë për herë të parë me ciklopin me një sy. Është një trillim i dobishëm. (Pasi hero i verboi syrin ciklopit, ky bërtet për ndihmë dhe u thotë fqinjëve të tij, “Askushi po më lëndon”, kështu që ata e lanë në fatin e vet.) E, megjithatë, në një kuptim tjetër, ky emër i rremë është çuditërisht i vërtetë: Odiseu ka qenë larg shtëpisë dhe i konsideruar i vdekur për shumë kohë, sa që realisht është bërë askushi. Lufta e tij për të rifituar identitetin, për t’u bërë sërish dikushi, përbën harkun më të madh të epopesë. Gjatë aventurave të tij të famshme, talenti i këtij mashtruesi për të ndryshuar pamjen e jashtme dhe për të gënjyer mbi jetën e vet i shpëton jetën. Por, kur kthehet në shtëpi, kjo aftësi kthehet në problem: kur më në fund ribashkohet me gruan e tij, Penelopën, ajo është e prirë të mos e besojë se ky i huaj, që vetëm pak çaste më parë dukej si një lypës plak dhe i dërmuar, është vërtet i njëjti burrë të cilin ajo e përcolli



Gdhendje në dru e portretit të imagjinuar të Homerit, poetit të lashtë grek, për të cilin thuhet se jetoi në shekullin VIII p.e.s., marrë nga vepra “Historia e përgjithshme” [“Allgemeine Geschichte”] nga Karl von Rotteck (1775–1840), botimi i tetë i redaktuar nga Wilhelm Zimmermann (1807–1878), Shtëpia Botuese “Rieger”, Shtutgart, 1869

shumë kohë më parë. Edhe pse ai më në fund e bind atë (duke këmbyer një lloj “fjalëkalimi” të fshehtë të lashtë), prapë mbetet pyetja më shqetësuese: Si mund të jetë ende i njëjti person pas dy dekadash përvojash dhe vuajtjesh që ndryshojnë jetën? Ky paradoks ngjall disa prej pyetjeve më të thella që kjo vepër e lashtë vazhdon të shtrojë – pyetje që më prekin më shumë se kurrë, më shumë se një dekadë pas vdekjes së babait tim. Çfarë është në të vërtetë identiteti? Cili është dallimi midis unit të brendshëm dhe atij të jashtëm – midis unit që mbetet konstant në udhëtimin nga lindja në vdekje, dhe unit që ia paraqesim botës e që shpesh ndryshon nga rrethanat jashtë kontrollit tonë, si dhimbja, trauma, apo edhe procesi i thjeshtë i plakjes? Si është e mundur që gjithmonë ndjejmë se jemi vetvetja, edhe pse e pranojmë se ndryshojmë me kohën, fizikisht dhe emocionalisht? Kam ligjëruar për Odisenë për gati katër dekada, por nuk mbaj mend ndonjë kohë kur ajo t’u ketë folur studentëve të mi më fuqishëm sesa sot, kur kaq shumë prej tyre përqafojnë identitete fluide dhe kërkojnë të drejtën për vetëzbulim.

Një rezonancë tjetër për lexuesit bashkëkohorë është ndjesia e – nuk ka fjalë më të saktë – pasta-

jmes që përndjek Odisenë. Në Iliadë, perënditë janë gjithnjë të pranishme, dhe njerëzit udhëhiqen nga bindja e patundur se veprat heroike në betejë do t’u sjellin lavdi të përjetshme pas vdekjes. E gjithë kjo tashmë është pjesë e së kaluarës te Odiseja. Lufta e madhe ka mbaruar, heroizmi i dikurshëm është bërë i vjetruar, dhe perënditë kryesisht janë tërhequr, duke mos u përzier më ngushtë me punët e njerëzve. Heroi i Odisesë, pra, bëhet një figurë e njohur: një vetmitar në një botë post-historike. Odiseu udhëton nëpër peizazhe të paqarta dhe shpesh armiqtësore, duke naviguar përmes krijesave dhe popujve të çuditshëm, për të cilët është e pamundur të kesh ndonjë siguri rreth zakoneve, ideologjive, qëllimeve apo karakterit të tyre – në kërkim të një destinacioni që ndoshta nuk ekziston më. Kjo dilemë është krejt e huaj për Iliadën, por ajo parashikon enigma të ngjashme me ato të heronjve modernistë të Kafkës [Franz Kafka] dhe Xhojsit [James Joyce]. Tani jam dymbëdhjetë vjet më i vjetër sesa isha kur rrija pranë babait tim në dhomën e tij të spitalit. Ashtu si për Odisenë, ashtu si për të gjithë, vitet më kanë ndryshuar – dhe megjithatë e ndiej veten të jem po i njëjti njeri. Ky paradoks i

identitetit – i babait tim, i imi – ka ndryshuar mënyrën se si e përjetoj Odisenë. Kur e lexoj tani, e shoh se kjo poezi epike është një vepër për sfidën shpesh të pakuptueshme të pranimit të asaj që është më njerëzore te ne, përfshirë edhe vdekshmërinë tonë, në një kohë të pasigurisë së madhe. Jo rastësisht poeti thekson se Odiseu refuzon ofertën e nimfës Kalipso për jetë të përjetshme, duke preferuar të kthehet te gruaja e tij e plakur – duke preferuar të vdesë me të sesa të jetojë përgjithmonë pa të. Po ashtu, jo rastësisht Homeri e vendos Odisenë në Tokën e të Vdekurve përballë fantazmës së Akilit, heroit më të madh të Iliadës, i cili i thotë mikut të vjetër se do të preferonte të ishte skllavi i një fshatari, por që të ishte sërish gjallë, sesa mbret i të gjithë të vdekurve – duket si një mohim tronditës i vlerës së dikurshme heroike: lavdia me çdo kusht, edhe me çmimin e jetës.

Pra, kush ndihet i habitur kur Odisenë e shohim gjithandej rreth nesh sot? Sado të çuditshme të jenë origjinat dhe mjediset e epikës, bota që ajo pikturon – me shqetësimet e saj për gjininë dhe pushtetin, mërgimin dhe përkatësinë, rrëfimin dhe identitetin – është një botë të cilën e njohim shumë mirë. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Kuka: Kosova edhe një herë epiqendër e xhudos botërore

PEJË, 30 MAJ - Trajneri i mirënjohur i xhudos, Driton Kuka, ka njoftuar në rrjetet sociale, se Peja dhe Kosova janë shndërruar edhe një herë në epiqendër botërore të xhudos, pasi garues nga shumë shtete të njohura po qëndrojnë në Kosovë. Kosova është një nga shtetet

më të trofeshme në dekadën e fundit në xhudon botërore, pasi ka nxjerrë garues të mëdhenj si Majlinda Kelmendi, Distria Krasniqi, Akil dhe Nora Gjakova të cilat kanë fituar vazhdimisht medalje. Rezultatet kulminante të garuesve të Kosovës kanë

bërë që xhudistët e shteteve botërore të vijnë në vendin tonë për t'i marrë mësimet më të mira për këtë sport nga trajneri Driton Kuka dhe xhudistët elitarë. “Në Pejë këto ditë po qëndrojnë ekipe nga Bosnja, Suedia, Japonia, Portoriko, Holanda e javën tjetër do të kemi edhe ekipe e

garues nga Gjermania ku, pos sportistëve, do ta kemi edhe kryetarin e qytetit Potsdam, një mik i madh i shqiptarëve atje, po ashtu mysafirë të tjerë. Peja dhe Kosova edhe një herë epiqendër e xhudos botërore! Kosova shtet i xhudos”, ka thënë Kuka.



Sonte finalja e madhe e Ligës së Kampionëve

“Epoka e re”

MUNCHEN, 30 MAJ - Emocionet e sezonit të futbollit evropian kulmojnë të shtunën mbrëma, kur Paris Saint-Germain dhe Inter Milan do të zbresin në fushën e “Allianz Arena” për të vendosur se kush do të shpallet kampion i Evropës për sezonin 2024/25. Kjo është një mundësi historike për klubin francez, PSG, që ta fitojë për herë të parë Ligën e Kampionëve, pas një dekade të mbushur me zhgënjime dhe pritje të gjata. Me Luis Enrique në stol dhe me një skuadër të mbushur me yje, francezët synojnë ta mbyllin sezonin në mënyrë të përkryer, pasi kanë fituar tashmë Ligën 1 dhe Kupën e Francës. Me një fitore ndaj Interit, kjo skuadër do të bëhet klubi i parë francez që fiton tripletën. “Është finalja e dytë për Interin në tri vitet e

fundit. Është përgatitur. Nuk ka bërë shumë ndryshime në skuadër. Është një ekip që dominon në goditjet standarde. Na takon neve të hyjmë në finale me gjendjen e duhur mendore. Kemi përparuar shumë këtë sezon dhe lojtarët janë rritur ndjeshëm. Mendoj se forca e skuadrës është gjëja më e rëndësishme. Mëson diçka çdo ditë pas shumë vitesh përvojë si trajner, dhe po përmirësohem vazhdimisht me këtë grup”, ka thënë Luis Enrique, trajneri i PSG-së. Ndërsa Interi kërkon të rikthehet në majën e futbollit evropian, pas një sezoni ku ambiciet për tripletë u shuan në

fundin e kampionatit dhe në Kupën e Italisë. Skuadra e drejtuar nga trajneri Simone Inzaghi ka treguar forcë dhe pjekuri gjatë rrugës drejt finales, duke eliminuar dy gjigantë si Bayern Munich dhe Barcelona. “Lojtarët bënë diçka të jashtëzakonshme. Luajtëm katër ndeshje të mahnitshme kundër dy skuadrave botërore si Bayerni dhe Barcelona. Ishte fantastike të festonim këtë arritje (arritjen në finale) këtu me tifozët tanë”, ka thënë Simone Inzaghi, trajneri i Interit. Të dyja skuadrat pritet të jenë pa asnjë mungesë serioze në prag të përballjes. Lautaro Martinez pritet të rikthehet në

FORMACIONET E MUNDSSHME:

Paris Saint-Germain: Donnarumma; Hakimi, Marquinhos, Pacho, Nuno Mendes; Joao Neves, Vitinha, Fabian Ruiz; Doue, Dembele, Kvaratskhelia.

Inter: Sommer: Bisseck, Acerbi, Bastoni; Dumfries, Barella, Calhanoglu, Mkhitaryan, Dimarco; Thuram, Martinez.



fushë për Interin pas një pauze, ndërsa PSG-ja ka në dispozicion

të gjithë titullarët, përfshirë Ousmane Dembele.

Foda publikon listën për ndeshjet e qershorit

Prishtinë, 30 maj - Përzgjedhësi i Kombëtares së Kosovës, Franco Foda, ka publikuar listën e futbollistëve të ftuar për dy ndeshjet miqësore që dardanët do t'i zhvillojnë në muajin qershor në kuadër të përgatitjeve për kualifikimet e Botërorit 2026 që nisin në shtator. Kosova do të përballlet fillimisht me Armeninë më 6 qershor, ndërsa tri ditë më pas do të luajë kundër Komoreve. Të dyja ndeshjet do të zhvillohen në stadiumin “Fadil Vokrri” në



Prishtinë, me fillim nga ora 19:00. Franco Foda do të mbështetet në

një grup i përzier i futbollistëve me përvojë dhe talentë të rinj për këto

përballje miqësore, të cilat do të shërbejnë si mundësi për të testuar opsione të ndryshme taktike dhe për ta konsoliduar grupin para ndeshjeve kualifikuese. Futbollistët do të grumbullohen të dielën, më 1 qershor, ndërsa seanca e parë stërvitore do të zhvillohet po atë ditë, në orën 17:00, në Kampin Nacional të FFK-së në Hajvali. Paraprakisht, në të njëjtën ditë, në orën 12:00 në hotel “Emerald” në Prishtinë përzgjedhësi Foda do të mbajë konferencë për medie.

LISTA E FUTBOLLISTËVE

Amir Saiqi, Visar Bekaj, Faton Maloku, Mërgim Vojvoda, Florent Hadergjonaj, Ilir Krasniqi, Ismail Beka, Lumbardh Dellova, Kreshnik Hajrizi, Leart Paqarada, Donat Rudhani, Dion Gallopi, Ermal Krasniqi, Muharrem Jashari, Vesel Dërmaku, Ismet Lushaku, Elvis Rexhepaj, Lindon Emërllahu, Bledian Krasniqi, Baton Zabërgja, Meriton Korenica, Florian Haxha, Florian Muslija, Albion Rrahmani, Fisnik Asllani.

Berisha, hero i Hackenit në Suedi

GOTHENBURG, 30 MAJ - Pati probleme të shumta, por duket se i ka lënë pas. Etrit Berisha ka gjetur veten në elitën e futbollit suedez, ndërsa që nga viti 2021 shpesh e pati parë veten në stol. I lënë jashtë kombëtares nga trajneri Silvinho edhe për ndeshjen ndaj Serbisë dhe

Letonisë, portieri veteran shkëlqeu në finalen e Kupës. Gardiani 36-vjeçar bëri pritje të shumta për skuadrën e tij, Hacken, ndaj Malmos, që ishte favorite për trofeun dhe që luajti më mirë. Shqiptari nga Prishtina ndaloi disa herë futbollistët kundërshtarë,

madje duke shmangur edhe gola të sigurt. Gjithsesi, kulmi arriti kur, pas 120 minutash lojë të rregullt dhe shtesë, u gjuajtën penalltitë. Berisha priti dy 11-metërsha, duke treguar se nuk e ka humbur aspak klasën e tij. Më pas mori përsipër një penallti dhe u tregua i saktë duke shënuar. Pra, pa e

tepruar aspak, mund të themi se ish-portieri kuqezi pati meritën më të madhe që ekipi i tij fitoi Kupën e Suedisë. Nuk dihet nëse Silvinho do të mendojë sërish për të dhe do ta kthejë në përfaqësuese. Në kombëtare, Berisha nuk është thirrur që nga shtatori i vitit të kaluar kur nisi



Liga e Kombeve, ndërsa gjatë finaleve të Evropianit ishte në stol, pasi titullar luajti Tomas Strakosha.

Gjimshiti viziton KF Tërrnocin: Gjithmonë krenar për rrënjët e mia

PRESHEVË, 30 MAJ - Kapiteni i Kombëtares shqiptare, Berat Gjimshiti, ka zhvilluar një vizitë emocionuese në vendlindje. Ai është pritur ngrohtësisht nga drejtuesit dhe futbollistët e rinj të Klubit KF Tërrnoci. Në këtë takim simbolik atij iu dhurua fanella me numrin 6 nga klubi,

në shenjë respekti dhe krenarie për arritjet e tij në futbollin ndërkombëtar. Gjimshiti pati rastin të bashkëbisedojë me futbollistët e rinj të klubit, duke ndarë me ta përvoja, këshilla dhe mesazhe motivuese. Me përlësi e singleritet, ai u uroi të rinjve që të arrijnë më shumë në

karrierë, duke theksuar rëndësinë e punës, disiplinës dhe dashurinë për vendin dhe sportin. Vizita e tij erdhi në prag të ndeshjes së rëndësishme të Shqipërisë me Serbinë, gjë që e bëri edhe më domethënëse praninë e tij në mesin e

bashkëfshatarëve. “Kudo që më çon futboli, kurrë nuk i harroj rrënjët. Të jem këtu sot është një emocion i madh për mua. Jam krenar që vij nga ky vend dhe gjithmonë do ta mbaj në zemër”, u shpreh Gjimshiti. Vizita e kapitenit të kuqezinjve në KF Tërrnoc u prit si një ngjarje e



veçantë për komunitetin, duke i dhënë shtysë dhe frymëzim brezit të ri të sportistëve që ëndërrojnë t'i ndjekin gjurmët e tij në arenën ndërkombëtare.

Reali zyrtarizon transferimin e Alexander-Arnold

MADRID, 30 MAJ - Një epokë e re nis në Madrid. Me një firmë, me një njoftim zyrtar, Real Madridi ka përforcuar radhët me një ‘yll’ të futbollit anglez: Trent Alexander-Arnold. Mbrojtësi i djathtë, që për shumë vjet ishte simbol i Liverpoolit, ka firmosur një kontratë gjashtëvjeçare që e lidh me “Los Blancos” deri në vitin 2031.

“Real Madrid CF dhe Liverpool FC kanë arritur një marrëveshje që do ta mbajë Trent Alexander-Arnold në klubin tonë për gjashtë sezonet e ardhshme, nga 1 qershori 2025 deri më 30 qershori 2031. Alexander-Arnold do të luajë me Real Madridin në Kupën e Botës për Klube, e cila do të mbahet në Shtetet e Bashkuara duke filluar nga 14 qershori”, thuhet në njoftimin e Real Madridit.

I njohur si “i pesti Beatle” apo si mjeshtri i këndit kundër Barcelonës, Trent është gjithashtu një mik i ngushtë i Bellinghamit, me të cilin do ta ndajnë dhomën e zhveshjes në “Santiago Bernabeu”.




Në moshën 26-vjeçare ai vjen për të sfiduar dhe trashëguar vendin e Dani Carvajal. Kalimi nuk ka qenë i lehtë. Marrëveshja ishte në tavolinë prej muajsh, por vonesat nga Liverpooli, që kërkonte ta mbante për Botërorin e Klubeve, vonuan gjithçka. Trent, megjithatë, mbeti i palëkundur: nuk donte të rinovonte dhe insistoi për kalimin te Real Madridi. Reali do të paguajë rreth 10 milionë euro për ta përsheptuar ardhjen e tij. Fillimisht mendohej një shumë

më e vogël, por përfshirja në Kupën e Botës për Klube kërkonte zgjidhje të menjëhershme. Liverpooli rezistoi gjatë, por më në fund dha miratimin. Alexander-Arnold do të bashkohet me Realin më 11 qershor, menjëherë pas angazhimeve me Anglinë, dhe do të ketë vetëm disa ditë për t'u përshtatur para debutimit në Botërorin e Klubeve më 18 qershor. Sfidë është e madhe, por madrilenët besojnë se kanë sjellë një tjetër “Galaktik”.

Verstappeni: Nëse makina është për të fituar, atëherë fitoj

WOKING, 30 MAJ - Piloti holandez i Red Bullit, Max Verstappen, kampion në fuqi dhe katër herë fitues i titullit në Formula 1, ka treguar një qëndrim të përmbytshëm dhe të rezervuar në lidhje me mundësitë e tij për të fituar titullin e pestë në sezonin 2025. Aktualisht, pas shtatë garave të para të sezonit, Verstappen gjendet 25 pikë prapa liderit Oscar Piastri dhe tri pikë prapa Lando Norris, të dy pilotë të McLarenit, që kanë dominuar këtë fillim kampionati. Edhe pse ka arritur dy fitore, performanca e përgjithshme e Red Bullit ka qenë e paqëndrueshme. “Unë thjesht përpiqem të bëj më të mirën dhe ta shijoj këtë proces. Më entuziazmon ideja se do të jemi të shpejtë. Kjo është ajo që më



motivon më shumë. Deri tani sezoni ka pasur disa momente pozitive, por edhe shumë negative. Në disa gara kemi qenë krejtësisht jashtë ritmit, e kjo është zhgënjyese”, ka thënë ai. Verstappen theksoi se makina Red Bull është e mirë në pista me shpejtësi mesatare dhe të lartë, si ajo e Barcelonës, por vuan në kthesa të ngadalta dhe në pista urbane me gunga apo ndryshime

të mëdha në sipërfaqe. “Nuk është se nuk besoj. Thjesht paraqitem në pistë dhe jap maksimumin çdo fundjavë. Nuk kam nevojë të besoj plotësisht. E di që sa herë hipi në makinë, jap gjithçka që kam”, ka shtuar Verstappen. “Nëse makina është për vendin e pestë, unë do ta çoj në vendin e pestë. Nëse është për të fituar, atëherë fitoj. Qasja ime është shumë e thjeshtë dhe nuk më lodh shumë mendërisht, kështu që kam shumë kohë të lirë jashtë pistës”, ka deklaruar ai. Gara e radhës do të zhvillohet në Barcelonë, në Çmimin e Madh të Spanjës, ku Red Bulli shpreson t'i shfrytëzojë karakteristikat e pistës për t'i rikuperuar pikët e humbura ndaj McLarenit dhe për ta mbajtur gjallë ëndrrën e titullit.

SHKURT

Më 2 qershor zhvillohet finalja e parë në futsall

Kampionati i Superligës së Kosovës në futsall hyn në fazën vendimtare me finalen mes dy ekipeve të forta, FC Prishtina 01 dhe FC Drenica. Ndeshja e parë e finales do të zhvillohet të hënë, më 2 qershor, ndërsa e dyta është planifikuar për të enjten, më 5 qershor. Nëse është e nevojshme, ndeshja e tretë dhe vendimtare do të luhet më 9 qershor. FC Prishtina 01 ka kaluar me sukses FC Mabetex Prishtinën në gjysmëfinale, ndërsa FC Drenica ka eliminuar FC Vjosën. Tashmë dy ekipet janë të gatshme të japin gjithçka për ta ngritur trofeun dhe për ta kurorëzuar sezonin me sukses. Ky klub para disa javësh fitoi Kupën e Kosovës.

Allegri, trajner i ri i Milanit

AC Milan ka zyrtarizuar emërimin e Massimiliano Allegrit trajner i ri pas largimit të Sergio Conceicao. “Rossonerët” dhe drejtori i ri sportiv, Igli Tare, nuk kanë qëndruar duarkryq. Puna e parë e Tares ka qenë gjetja e trajnerit të ri dhe kjo ka ndodhur brenda 72 orëve të tij të para në rolin e drejtorit sportiv. “AC Milan ka kënaqësinë të njoftojë se Massimiliano Allegri është emëruar trajner kryesor i ekipit të parë të meshkujve. Klubi i shpreh mirëseardhjen e ngrohtë dhe urimet më të mira Massimilianos dhe stafit të tij”, thuhet në komunikatën e kuqezinjve. Allegri thuhet se ka nënshkruar kontratë për dy vjet me mundësi vazhdimi edhe për një vit tjetër.

Beshiktashi kërkon 10 milionë euro për Muçin

Ernest Muçi po monitorohet nga klube italiane dhe gjermane. Beshiktashi kërkon plot 10 milionë euro për shitjen e kartonit të sulmuesit, siç raportohet në Turqi. Kjo shumë përkton me shpenzimin e kryer nga klubi turk te Legia, pikërisht në shkurtin e vitit 2024. Beshiktashi pretendon ta rifitojë shumën e investuar në këtë mënyrë. Muçi ka luajtur 54 ndeshje në Turqi. Gjatë kësaj kohe ka gjetur rrugën e rrjetës 11 herë dhe ka asistuar për katër gola. Kontrata e Muçit përfundon në vitin 2027. Edhe Beshiktashi pritet t'i marrë maksimumin në rast të shitjes së kartonit këtë verë.

Di Maria pas 18 vitesh rikthehet te Rosario Central

Angel Di Maria ka befasuar botën e futbollit me një zgjedhje zemre. Në moshën 37-vjeçare, “ylli” argjentinas është paraqitur zyrtarisht si lojtari më i ri i Rosario Central, klub ku ai hodhi hapat e parë si profesionist. Ky rikthim simbolik vjen pas 18 vitesh largim, duke mbyllur një rreth të madh në karrierën e tij të pasur. Pas përfundimit të aventurës dyvjeçare me Benfikën, Di Maria kishte në tryezë oferta shumë tërheqëse nga Arabia Saudite dhe Inter Miami, por zgjodhi ta ndjekë zemrën dhe jo paratë. Ai vendosi t'i japë fund karrierës në vendlindje, aty ku gjithçka nisi në vitin 2005. Kujtojmë se në vitin 2007 Di Maria u largua nga Rosario për të kaluar te Benfica, ndërsa tani historia përsëritet në drejtim të kundërt - pas aventurave në Portugali, Spanjë, Angli, Francë dhe Itali, ai rikthehet aty ku filloi gjithçka. Ky vendim është përsëritës dhe entuziazëm nga tifozët argjentinas dhe konsiderohet një akt i rrallë besnikërie në futbollin modern. Di Maria, përtej trofeve dhe lavdisë, po rikthehet për të dhënë edhe një herë gjithçka për klubin e zemrës.

New York fiton finalen e pestë ndaj Indianas


New York Nicks mban gjallë shpresat për finalen e madhe në NBA teksa në finalen e pestë të zhvilluar në New York të enjten, Nicks triumfoi përballë Indianës, duke e ngushtuar serinë në 3-2.

Skuadra e New York fitoi me rezultat 111-94 ndaj Indianas në fushën e saj, duke rihapur garën për titull në Konferencën e Lindjes. Tashmë skuadra e Indianas udhëheq 3-2 serinë finale. Një ndeshje në

përgjithësi e komanduar nga ekipi nju-jorkez, që pati epërsi në fushë. Jalen Brunson me 32 pikë ishte më i miri në fushë për vendasit, mbështetur edhe nga Karl-Anthony Towns me 24 pikë. Tek Indiana mungoi

lojtari-lider, teksa shënuesi më i mirë ishte Mathurin me 23 pikë, që e nisi ndeshjen nga stoli. Ndeshja e 6 finale do të luhet në fushën e Indianas. Një sfidë që mund të rezultojë të jetë deçizive, pasi Indiana

përballë publikut të saj do të kërkojë t'i mbyllë përfundimisht llogaritë, ndërsa New York do ta kërkojë fitoren në Indianapolis, në mënyrë që ta ketë avantazhin e ndeshjes finale në shtëpi.



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

facebook www.facebook.com/gjeipuneshpejte




RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministraskoo Pravde-Ministry of Justice

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar

Agencia za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom

Agency for Administration of Sequestrated and Confiscated Assets

Ftesë për Ankand Publik

Datë 28.05.2025 Referenca: AAPSK – 009/2025

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:


Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/ copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Seat Ibiza, viti i prodhimit 2009, dizel ngjyre e hirit- me targa vendore-Rishpallje	1 copë	3,150.00€		
2	Daimler Benz 124, viti i prodhimit 1985, dizel, ngjyrë hiri metalike-me targa vendore	1 copë	900.00€		
3	Daimler Chrysler 210 E 200 CDI Klasik,automatik,dizel, viti i prodhimit 1999, ngjyrë e kaltër e mbylltë metalike-me targa vendore	1 copë	2,000.00€		
4	Passat 3C, viti i prodhimit 2005, dizel, automatik,, ngjyrë e zezë metalike- me targa vendore	1 copë	4,700.00€		
5	VW Golf V,viti i prodhimit 2004, dizel ngjyre e hirit metalike-me targa vendore	1 copë	4,800.00€		
6	VW Golf II,viti i prodhimit 1991, ngjyrë vishnje- për skrap	1 copë/ për skrap	213.44€		
7	VW Caddy, viti i prodhimit 2005, dizel ngjyre e kuqe -me targa vendore	1 copë	2,000.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri më 04.06.2025 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 04.06.2025, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë,

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254



>> SHALLJE TË VOGLA <<

- Aurora Tarakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. dhe tri dëftesat të vitit të I,II,III të shkollës “Gjon Buzuku” Prizren.
- Sabina Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e shm Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Dion Zeqa shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10të shkollës së mesme të muzikës “Prenk Jakova” Gjakovë.
- Ema Kaja shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu “Mazllum Këpuska” Gjakovë nga kl. 6-9.
- Suela Jakupi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu “Yll Morina” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Vlera Deva shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 diploën dhe testin e maturës të gjimnazit “Hajdar Dushi” Gajkovë.
- Dialon Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Kongresi i Manastirit” Damjan Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Nexhat Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Kongresi Manastirit” Damjan Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veterikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

